



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 253, datë 12.11.2019

PËR
SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}, I DIPLOMUAR PËR MAGJISTRAT NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS DHE REFUZIMIN E EMËRIMIT TË TIJ SI
GJYQTAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35, pika 1, shkronja “c” dhe pika 4, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatore znj Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR